



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“PRODHIM DHE PRINTIM DIPLOMASH PËR NJËSITË SHPENZUESE TË  
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**30197600-2 - Letra të përpunuara dhe karton**

**Fondi limit: 1,484,255 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, i ndarë si më poshtë:**

Fakulteti i Mjekësisë: 742,660 (shtatëqind e dyzetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh.

Fakulteti i Mjekësisë Dentare: 166,495 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike: 575,100 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;

ç. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, pika të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922, datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë, fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore/polisa sigurimi për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015 ose ekuivalente**, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron. Menaxhimi i cilësisë i çertifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave. Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partnerët e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në tërësi. ISO 9001 ose ekuivalent, përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë ambjenteve të Rektoratit të UMT-së, një mostër diplome horizontale dhe një mostër diplomë vertikale, në të cilën të jenë integruar elementët dhe proceset teknike si dizajni, ngjyra, relievi, element sigurie, etj., duke krijuar nje produkt të ngjashëm me ato të kërkuara në specifikimet teknike në të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit. Mostra e kërkuar duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur.

***Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është kërkuar bazuar në pikën 6 të Nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas së cilës: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike, Mostrat trajtohen si informacion konfidencial dhe janë në kontroll të autoritetit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë AK se mallrat që do të furnizojë do të jenë cilësore, pra lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë cilësinë e diplomave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin nga një mostër për vlerësimin e ofertës teknike të OE. Kështu vendosja e mostrës do të shërbejë për të treguar që, operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi, të jenë në gjendje të përgatisin qartë ofertën e tyre ekonomike dhe të provojnë se zotërojnë kapacitete teknike për të prodhuar diploma/shtypshkrime me element sigurie të lartë. Diplomat nuk janë produkt i gatshëm që gjendet në treg por prodhohen vetëm me porosinë e AK, pasi përbëjnë dokumente me rëndësi dhe natyrë të veçantë, ku aplikimi i elementëve të sigurisë është mëse i domosdoshëm për të mënjeluar falsifikimin e diplomave.

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Objekti i kësaj kontrate është prodhimi dhe shtypshkrimi me diploma për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, i cili përfshin Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Mjekësisë Dentare dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.**

- **Diplomat do të jenë me letër 300 gr/m<sup>2</sup>, super-fine**
  
- **Formati vertikal**
  - a. Përmasat
    - me përmasa të letrës ( a x b ) - 22.4 x 33.3 cm.
    - me kornizë të jashtme ( perimetrale ) me ngjyrë blu, me gjerësi 2.3 cm.
    - me kornizë të brendshme ( perimetrale ) me ngjyrën e letrës, me gjerësi 1 mm.
    - me kornizë të brendshme ( perimetrale ) në ngjyre argjendi, me gjerësi 3 mm.
    - me kornizë të brendshme, ku do të realizohen printimet, me përmasa ( a x b ) – 17.0 x 27.9 cm.
  
- **Formati Horizontal**
  - a. Përmasat
    - me përmasa të letres ( a x b ) – 33.3 x 22.4 cm.
    - me kornizë të jashtme ( perimetrale ) me ngjyrë blu, me gjerësi 2.3 cm.
    - me kornizë të brendshme ( perimetrale ) me ngjyrën e letrës, me gjerësi 1 mm.
    - me kornizë të brendshme ( perimetrale ) në ngjyre floriri, me gjerësi 3 mm.
    - me kornizë të brendshme, ku do te realizohen printimet, me përmasa ( a x b ) – 27.9 x 17.0 cm.
  
- **Printimet mbi karton:**

- Printim i dixhitalizuar i të dhënave në Diplomë me 4 ngjyra LASER-cmyk (kategorikisht jo printime ink). Sfond 97-98 % 4-color-cmyk, hapësira e printimit mbi karton sipas përcaktimeve të formateve horizontale dhe vertikale.
- Mbi të gjithë sipërfaqen vendoset një shtresë e konfiguruar Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Republika e Shqipërisë me shkrim të minimizuar që nuk lexohet me sy të lirë, duke veshur të gjithë pjesën e bardhë të diplomës
- Nr.serie me ngjyrë të kuqe, Nr. i diplomës së studimeve të mëparshme dhe Nr. unik i identifikimit të diplomës me ngjyre te zezë.

- **Stampimet mbi karton:**

- Logo e Republikës duhet të jetë me tre ngjyra, stampim i nxehte (varak ).
- Stampimi i emërtesës DIPLOMË (1cm x 6,5 cm), me thellësi të goditjes 0,5 mm
- Stampimi i emërtesës DEKANI (0,4cm x 2 cm) dhe REKTORI (0,4cm x 2,2cm) me thellësi të goditjes 0,5 mm.
- Shiriti i kornizës së brendshme ( perimetrale ) me gjerësi 3 mm me stampim të nxehtë dhe kuposje.

- **Elemente sigurie:**

- Logo e UMT-së, formati 2,2 cm x 1cm në fund të kartonit (si në modelin e skanuar bashkëlidhur) holograme me refleks ngjyrë argjendi në diplomat vertikale dhe me refleks ngjyrë floriri në diplomat horizontale.
- Në sipërfaqen e diplomës të vendoset logo U-Vizibël me përmasa 12 cm x 5 cm. Të gjitha elementet shfaqen me reflekse të ndryshueshme sipas planit të shikimit.
- Pulla duhet të ketë elemente sigurie të dukshme dhe të maskuar (holografikë dhe joholografikë) që sigurojnë vlerësimin e origjinalitetit të saj Ngjitje holograme 2-color rrethore  $\varnothing$  25 mm. Pulla përgatitet me material vetë-ngjitës, që priset nëse tentohet të çngjitet;

- **Të dhënat e hologramës(pulla) si më poshtë:**

- Në Diplomate vertikale pulla ka formë rrethore me diametër  $\varnothing$  25 mm, ngjyrë argjendi dhe me goditje germat UMT. Germat UMT kanë orientim në 2 dimensione të cilat evidentohen sipas refleksionit, ngjyrë argjendi;
- Në Diplomate horizontale pulla ka formë rrethore me diametër  $\varnothing$  25 mm, ngjyrë floriri dhe me goditje germat UMT . Germat UMT kanë orientim në 2 dimensione të cilat evidentohen sipas refleksionit, ngjyrë floriri;

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim Znj. Ilva Ymeraj.

**NJËSIA E PROKURIMIT:**